



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AKADEMIA E SHKENCAVE
KRYESIA

768
Nr. ... prot.

Tiranë, më 13.12.2021

Vendim

Nr. 71 datë 13.12.2021

Për ngritjen e njësisë së kërkim-studimit në fushën e energjive të ripërtëritshme, sistemit elektroenergjetik dhe eficiencës së energjisë

Mbështetur në nenin 19, të ligjit nr.53/2019 Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë dhe nenin 45 të statutit të saj, me propozimin e disa prej anëtarëve të Komisioneve të përhershme të Inxhinierisë dhe të fizikës dhe kimisë pranë ASH, paraqitur nga Kryetari i SSHNT bashkëngjitur, si dhe relacioni për marrjen e mendimit në Seksion me tabelën e rezultatit (bashkëngjitur). Kryesia e Akademisë së Shkencave në mbledhjen e saj të datës 13.12.2021,

Vendosi:

I.Të ngrejë pranë ASH-së, njësinë e përkohshme të kërkim-studimit në fushën e energjive të ripërtëritshme, sistemit elektroenergjetik dhe eficiencës së energjisë.

II.Njësia ka si qëllim:

1. Identifikimin dhe vlerësimin e burimeve aktuale energjetike të vendit;
2. Koordinimin e punës kërkimore shkencore për zgjidhjen e problematikave komplekse dhe zhvillimet aktuale në fushën e sistemeve elektroenergjetike dhe për rritjen e eficiencës së energjisë;
3. Përdorimin e metodave moderne efikase për modelimin, simulimin dhe zbatimin e proceseve teknologjike dhe inxhinierike të përshtatshme për kushtet

e vendit, të cilat çojnë drejt shfrytëzimit optimal të burimeve alternative për energji.

III. Njësia përbëhet nga tre grupe kërkimore:

- Grupi kërkimor për energjitë e ripërtëritshme (me drejtues akad. Ilirjan Malollari);
- Grupi kërkimor për sistemin elektroenergjetik të shpërndarjes (me drejtuese akad. asoc. Rajmonda Bualjoti);
- Grupi kërkimor për eficiencën e energjisë (me drejtues akad. Jorgaq Kaçani).

IV. Objekti i punës së njësisë është realizimi i detyrave të përcaktuara në platformë dhe në programin e punës (bashkëngjitur) .

V. Grupi drejtues i njësisë përbëhet nga:

- Akad. Ilirjan Malollari;
- Akad. Rajmonda Bualjoti

VI. Njësia në veprimtarinë e saj do të mbështetet në infrastrukturën shkencore që ekziston në IAL dhe ente të tjera vendase.

VII. Koha e veprimtarisë është deri në 2 vjet.

VIII. Akademia e Shkencave siguron mbështetjen logjistike dhe mbulon shpenzimet financiare për veprimtarinë e njësisë.

IX. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi: Sekretari Shkencor i ASH, Kryetari i Seksionit të Shkencave Natyrore Teknike dhe Kancelari.

X. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Akad. Skënder GJINUSHI

KRYETAR

